



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

Pasqyrë e **INDUSTRIË SË PLASTIKËS DHE GOMËS**



Pasqyrë e Industrisë së Plastikës dhe Gomës

***Sektor me perspektivë
premtuese***

Ky raport është financuar nga Ministria për Punë të Jashtme të Finlandës në kuadër të projektit “Ndihmë Tregtisë”, që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

**Autorë:**

Artane Rizvanolli

Anketa është realizuar nga UBO Consulting

Sigurimi i cilësisë i ofruar nga:

Departamenti i Industrisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ekipi i projektit “Ndihmë Tregtisë”, UNDP

Faqesja:

Studio “InDesign”, Prishtinë

Një mirënjohje e veçantë u takon të gjithë të anketuarve të këtij studimi.

Ky dokument nuk ka të drejtë autoriale prandaj përmbajtja e tij mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të UNDP-së. Mirëpo, burimi i saj, duhet të citohet.

Pikëvështrimet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Ministrisë për Punë të Jashtme të Finlandës.

Hyrje

Ky profil i sektorit ofron informatat themelore mbi zhvillimet e fundit në sektorin e gomës dhe plastikës në Kosovë. Si rrjedhojë, profili mbulon firmat e regjistruara nën kodin 22 të klasifikimit NACE Rev. 2 (Nomenclature des Activités Économiques dans la Communauté Européenne).

Profilu kryesisht bazohet në burimet zyrtare të të dhënave; një anketë të ndërmarrjeve të kryer nga UNDP për qëllime të këtij raporti; dhe një analizë të hollësishme me menaxhmentin e njërës nga kompanitë më të suksesshme në sektor, Ferplast (Ferizaj). Diskutimi i karakteristikave të përgjithshme të sektorit, përfshirë madhësinë dhe përbërjen e sektorit, bazohet në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). Bilanci tregtar i sektorit bazohet në të dhënat e ofruara nga Dogana e Kosovës. Të gjithë treguesit në nivel të firmës mbi karakteristikat dhe performancën e sektorit bazohen në të dhënat e anketës të komisionuara nga UNDP-ja gjatë periudhës tetor - nëntor 2015. Një mostër prej 230 nga 526 firmat private të regjistruara nën kodin 22 të NACE në bazën e të dhënave në ATK janë anketuar për qëllime të këtij studimi. Duke pasur parasysh se sektori kryesisht përbëhet nga firma të nivelit mikro, anketa është përpjekur të mbulojë të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe një mostër të rastësishme të mikro-ndërmarrjeve; megjithatë, për shkak të mos-përgjigjes janë anketuar vetëm 24 nga 37 ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për më tepër, disa firma të regjistruara nën kodin 22 në fakt nuk prodhojnë produkte të gomës/plastikës (në mesin e produkteve të tyre kryesore) dhe janë përjashtuar nga mostra. Si rrjedhojë, mostra e përdorur përfundimisht përbëhet nga 225 firma.

Për qëllime të kësaj analize, rezultatet janë ndarë në vetëm dy sektore: prodhimin e artikujve të plastikës për ndërtimtari dhe 'produktete tjera të plastikës dhe gomës,' e cila përfshinë firmat që bien nën të gjitha kodet tjera NACE më lartë dhe dominohet nga produktet e plastikës (jo të gomës). Ky nivel i ndarjes është përzgjedhur për shkak të përqendrimit të firmave në artikujte plastikës për ndërtimtari e cila lë nën-sektorët tjerë me mostra që janë shumë të vogla për të qenë përfaqësuese; dhe vështirësitë në klasifikimin e shumë firmave që prodhojnë një kombinim të produkteve që bien brenda nën-sektorëve të ndryshëm NACE.

Ekziston një përqendrim gjeografik i firmave që prodhojnë plastikë dhe gomë në Kosovë: Prishtina dhe Prizreni përbëjnë pothuajse gjysmën e firmave në sektor. Shumica e firmave prodhojnë produkte të plastikës, ku në mesin e këtyre dominon prodhimi i mjeteve të ndërtuesve nga plastika (si dyert, dritaret, grilat), pasuar nga 'produktet e tjera' (si enët dhe enët e gatimit), paketimi i mallrave dhe gypat, fletët dhe profilet. Shpërndarja e punonjësve bazohet në një model gjerësisht të ngjashëm, me prodhimin e mjeteve nga plastika të ndërtuesve që përbën rreth gjysmën e punësimit (të regjistruar).

Në vitin 2015, sektori i plastikës dhe gomës ka punësuar në mënyrë formale mbi 1,700 punonjës, ndërsa me gjasë ka edhe një numër të konsiderueshëm të punonjësve jo formal. Sipas të dhënave të anketës, dy të tretat e punonjësve të sektorit janë të moshës ndërmjet 30 dhe 49 vjeç. Përqindja e grave punonjëse është e ulët, por ka pësuar një ngritje të shpejtëvitin e kaluar (nga 5% në 16%). Pronësia e grave në këtë sektor është e papërfillshme, siç është edhe pronësia e huaj.

Në vitin 2014, më shumë se gjysma e firmave kanë raportuar një prodhim vjetor në intervalin ndërmjet 10,000€ dhe 100,000€, ndërsa gjatë tremujorit tjetër raporton një nivel më të lartë të prodhimit. Rreth 40% e firmave raportojnë që rezultati i tyre ka përjetuar një rritje vit pas viti në vitin 2014 dhe madhësia mesatare e rritjes është më e lartë në prodhimin e produkteve tjera të plastikës (dhe gomës), në krahasim me nën-sektorin më të zhvilluar të mjeteve nga plastika të ndërtuesve. Firmat e anketuara gjithashtu kanë tendenca të raportojnë rritjen e fuqisë së tyre punëtore gjatë viteve të fundit (me 2% nga vitin vit në vitin 2014 dhe pastaj me 11% në tetor/nëntor të vitit 2015 në krahasim me vitin 2014), dhe krijimi i punësimit nuk është përqendruar në disa firma të suksesshme.

Perspektiva e sektorit duket e ndritshme: firmat kanë tendenca që të raportojnë pritjet e tyre për rritje të shitjeve dhe punësimit në firmën e tyre në krahasim me vitin paraprak si dhe një vlerësim që sektori i tyre është duke u rritur. Në përputhje me të gjeturat nga viti paraprak, prodhuesit e produkteve tjera nga plastika (dhe goma) raportojnë një perspektivë relativisht më pozitive në krahasim me ato të mjeteve nga plastika të ndërtuesve.

Të dhënat themelore dhe karakteristikat e industrisë

Sipas bazës së të dhënave të ATK-së, në vitin 2015, shumica e 531 bizneseve ishin mikro-biznese (Figura 1). Vetëm 1% e ndërmarrjeve në këtë sektor punësojnë 50 apo më shumë punonjës; megjithatë, asnjëra nuk është kompani e madhe (d.m.th. me 250 apo më shumë punonjës).


Figura 1: Madhësia e firmave në industrinë kimike



Burimi: ATK (2015)

Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari plastika (të cilat përfshijnë dyert, dritaret, etj.) është aktiviteti më i shpeshtë i firmave në këtë sektor, duke përbërë 59% të firmave (Figura 2). Nën-sektorët tjerë përfshijnë prodhimin e produkteve 'tjera' nga plastika (të cilat përfshijnë enët e gatimit, etj.), prodhimin e mallravenë paketim nga plastika (shishet, qeset, etj.) dhe prodhimin e pllakëzave, fletëzave, tubave dhe profileve nga plastika.


Figura 2: Struktura e firmave sipas aktivitetit



Burimi: ATK (2015)

Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari mbizotëron në aspektin e krijimit të firmave, duke përbërë 61 % të numrit të firmave të regjistruara rishtazi mes janarit të vitit 2012 dhe shtatorit të vitit 2015, përderisa paketimi dhe produktet tjera përbëjnë një pjesën prej 32% (Figura 3).


Figura 3: Struktura e firmave të krijuara rishtazi për periudhën 2012-2015



Burimi: ARBK (2015)

Ekziston një përqëndrim gjeografik i firmave në sektorin e gomës dhe plastikës. Prishtina përbën pjesën më të madhe të firmave në këtë sektor, e pasuar nga Prizreni, Gjilani dhe Ferizaj (Figura 4).

Figura 4: Lokacioni gjeografik i firmave në industrinë plastike



Burimi: ATK (2015)

Sipas të dhënave të ATK-së, 77% e firmave në sektorin e gomës dhe plastikës janë regjistruar si firma individuale. Rezultatet e anketës tregojnë se pronarët e firmave në këtë sektor janë kryesisht shqiptarë dhe të gjinisë mashkullore. Pronësia e huaj dhe pronësia e femrave është e pashmangshme (rreth 3% secila). Nga pronarët e huaj, gjysma janë anëtarë të diasporës.

Shumica e pronarëve të firmave (85%), përfshirë të gjitha pronaret gra, kanë përfunduar arsimin sekondar si nivelin më të lartë të arsimimit; pjesa e mbetur kanë kryesisht të përfunduar arsimin e lartë.

Prodhimi i firmave/industrisë

Firmat për prodhimin e plastikës dhe gomës kryesisht i importojnë lëndët e para dhe lëndët e para gjysmë të përpunuara. Më shumë se gjysma (59%)e firmave të anketuara importojnë të gjitha lëndët e para, ndërsa 18% blejnë produkte të prodhuara në nivel lokal (Tabela 1). Lënda e parë dhe materialet e papërpunuara të importuara kryesisht furnizohen nga tregtarët lokalë.

Tabela 1: Struktura e lëndës së parë dhe produkteve e papërpunuara


Burimi i lëndëve të para dhe produkteve të ndërmjetme	Përqindja e kompanive (%)
Të prodhuara ekskluzivisht në nivel lokal, nga të cilat	18
Prodhimi i brendshëm apo përzjerje e atij të brendshëm dhe tjera	4
Prodhuesit lokal	14
Përzjerja e atyre të prodhuara në nivel lokal dhe të importuara	23
Të importuara në mënyrë ekskluzive, nga të cilat	59
Prodhuesit lokal	40
Tregtarët apo prodhuesit ndërkombëtar	10
Përzjerja e burimeve të mësipërme të importit	9

Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Produktet më të importuara janë polietileni me densitet të lartë (HDPE), Polivinilili klorurit (PVC) dhe Fibrat e Polipropilenit (PP), profilet dhe foljetPVC, xhami¹, etj. Produktet e importuara vijnë kryesisht nga Gjermania (duke përbërë pothuajse dy të tretat e vlerës së importeve), pasuar nga Hungaria, Maqedonia, Austria, Turqia dhe Serbia.

Nga kompanitë të cilat kanë raportuar rezultatet² e tyre, rreth dy të tretat kanë raportuar produkte ndërmjet 10,000 dhe 100,000 Euro (Figura5). Në mesin e firmave që kanë raportuar rezultatin e tyre për të dyja vitet, pothuajse 40% kanë raportuar rritje në vlerën e prodhimit në vitin 2014, 40% tjera nuk kanë raportuar ndonjë ndryshim në prodhim, ndërsa 20% kanë raportuar rënie.

1 Vëreni që dritaret janë prodhimi më i zakonshëm i sektorit.
2 143 në vitin 2013 dhe 152 në vitin 2014.


Figura 5: Vlera vjetore e prodhimit, 2013 dhe 2014

Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Në përgjithësi, prodhimi në këtë grup të firmave është rritur prej rreth 3% nga viti në vit. Ndarja e shifrave sipas nën-sektorit shpalos se rritja e nën-sektorit më të madh të mjeteve të plastikës të ndërtuesve ishte 1%, ndërsa prodhimi i produkteve tjera të plastikës dhe gomës është rritur prej 7.5%, duke treguar një trend të diversifikimit të sektorit.

Perspektiva e industrisë

Perspektiva e sektorit perceptohet të jetë pozitive, me 40% të firmave që raportojnë që sektori i tyre është duke u rritur (Figura 6). Prodhuuesit e mallrave 'tjera' plastike raportojnë një perspektivë më pozitive.


Figura 6: Perceptimet e perspektivës së performancës së sektorit

Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Tregtia nderkombetare

Eksportet e sektorit janë rritur gjatë viteve të fundit. Në vitin 2014, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës janë rritur për 22% nga viti në vit (Figura 7). Ndërmjet tremujorit të parë dhe të tretë të vitit 2015, eksportet janë rritur prej 4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 7: Bilanci tregtar i sektorit (në miliona €)



Burimi: Dogana e Kosovës (2015)

Përqindja e firmave eksportuese është rreth 25% dhe eksportet zakonisht përbëjnë 10%-20% të prodhimit të firmave eksportuese (13% në mesatare). Numri i firmave eksportuese është rritur në mënyrë të konsiderueshme (prej 25%) në vitin 2014 në krahasim me vitin paraprak.

Sipas të dhënave të anketës, eksportet kryesore të sektorit janë dyert dhe dritaret, pasuar nga grilat e dritareve, gypat dhe profilet, orënditë e kuzhinës, etj., dhe destinacionet kryesore të eksportit janë Gjermania dhe Zvicra, pasuar nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Austria dhe disa vende të BE-së.

Rubrika 1: Dokumentet e kërkuara për tregtinë ndërkufitare

Dokumentet e nevojshme për eksport:

- Dokumenti Administrativ i Vetëm (d.m.th. deklarata doganore)

- Fatura komerciale

Dokumentet e nevojshme për import:


- Dokumenti Administrativ i Vetëm (d.m.th. deklarata doganore)

- Fatura komerciale

- Certifikata e Origjinës (për vendet me të cilat Kosova ka MTL apo ndonjë marrëveshje tjetër e cila mbulon përjashtimet bazuar në rregullat e origjinës)

Figura 8 më poshtë paraqet intensitetin e barrierave siç janë raportuar nga firmat që aktualisht eksportojnë në sektor. Barrierat me intensitetin më të lartë në eksport konsiderohen të jenë mundësitë e kufizuara të rrjetëzimit me firmat e huaja, kostoja e lartë e garancive bankare, procedurat doganore dhe mungesa e kredive për eksporte.

Figura 8: Barrierat në eksportim



Vëreni se kostoja e transportimit është identifikuar si njëra nga barrierat kryesore në një anketë të ngjashme të sektorit të tekstilit të realizuar në vitin 2013; megjithatë, intensiteti i kësaj barriere është në mënyrë të konsiderueshme më i ulët në këtë anketë të sektorit të plastikës, e cila mund të jetë për shkak të investimeve të fundit në infrastrukturën rrugore.

Rubrika2: Rregulloret tregtare dhe marrëveshjet për tregti të lirë

Kosova ka një normë të përgjithshme të sheshtë prej 10% për importe dhe 0% për eksporte. Nuk janë vendosur taksa doganore në importe të teknologjisë apo në produktet e papërpunuara që janë ri-eksportuar (pas përpunimit). Nga viti 2014 është fuqizuar Ligji Nr. 04/L-163 mbi mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, sipas të cilit disa produkte për këtë sektor (si plastika dhe goma në formën primare, profilet e plastikës, disa artikuj të paketimit, etj,) trajtohen si produkte me tarifë zero doganore.

Kosova është anëtare e CEFTA dhe gëzon të drejtat e qasjes pa doganë në BE sipas Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim dhe në SHBA sipas Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (GSP). Kosova gjithashtu ka nënshkruar marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë, por kjo akoma nuk është fuqizuar. Kosova përfiton nga preferencat tregtare me Japoninë dhe Norvegjinë e cila përfshinë vetëm disa kufizime.

Burimet njerëzore

Sipas statistikave zyrtare (ATK, 2015), sektori i plastikës dhe gomës ka punësuar rreth 1,734 punonjës në vitin 2015. Firmat e mbuluara në këtë studim kanë tendenca të raportojnë rritjen në punësimin gjatë disa viteve të fundit. Në firmat e përfshira në hulumtim, punësimi i raportuar është rritur me 2% nga viti në vit në 2014 dhe pastaj përsëri me 11% në vitin 2015 në kohën e anketimit, në krahasim me vitin 2014. Nuk ka arsye për të besuar që shifra e fundit paraqet efektet sezonale: anketa është realizuar gjatë periudhës tetor-nëntor 2015, ndërsa çfarëdo efekte sezonale në këtë sektor do të priten të nxiten nga aktivitetet e ndërlidhura me ndërtimin dhe kështu të arrijnë vlerën më të lartë në muajt në fillim të vitit. Për më tepër, krijimi i punësimit nuk është përqëndruar në disa firma të suksesshme: në vend të kësaj, 31% e firmave kanë raportuar një rritje në punësim në vitin 2015 (dhe 48% tjetër nuk kanë raportuar ndryshim). Dinamikat e punësimit duket të sugjerojnë që sektori është duke u konsoliduar pasi që po krijohet punësimi i ri në ndërmarrjet e vogla (dhe të mesme), ndërsa mikro-ndërmarrjet janë duke u zvogëluar (Tabela 2).

Tabela 2: Krijimi i punësimit sipas madhësisë së firmës

Madhësia e kompanisë	2014	2015
Të vogla dhe të mesme (10-249 punonjës)	13%	27%
Mikro (≤9 punonjës)	-9%	-5%
Gjithsej	2%	11%

Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Në përputhje me të gjeturat e rritjes së prodhimit, atëherë kur të dhënat ndahen sipas nën-sektorit, një normë më e lartë e rritjes së punësimit konstatohet në prodhimin e produkteve tjera të plastikës dhe gomës në krahasim me prodhimin e artikujve të plastikës për ndërtimtari (Tabela 3).


Tabela 3: Krijimi neto i punësimit sipas nën-sektorëve

Nën-sektori	2014	2015
Mjetet e plastikës së ndërtuesve	0%	4%
Produkte të tjera të plastikës	6%	12%
Gjithsej	2%	11%

Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Rreth dy të tretat e fuqisë punëtore në sektorin e plastikës dhe gomës kanë shkollim të mesëm si nivelin më të lartë të arsimimit dhe 14% kanë përfunduar arsimin e lartë (Figura 9).

Figura 9: Struktura e punonjësve sipas nivelit arsimor



Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Një nga pesë bizneset e anketuara identifikojnë si problem disponueshmërinë dhe koston e punonjësve të aftësuar. Edhe mungesa e arsimimit profesional dhe të diplomuarve në arsimin e lartë në fushat relevante, në veçanti, identifikohet si problem nga rreth një në katër biznese.

Profesionet specifike për sektorin që më së shpeshti përmenden si mungesë janë: inxhinierët/teknologët për materialet nga plastika, operuesit e makinave për përzierje dhe prodhim për produktet nga plastika, instaluesit e produkteve të plastikës dhe kimistët për materialet plastike. Profesionet tjera (të përgjithshme) që janë raportuar të kenë mungesë të fuqisë së duhur punëtore janë zyrtarët për marketing dhe marrëdhënie me publikun dhe zyrtarët për kontrollin e cilësisë.

Firmat në sektor i rikthehen ofrimit të trajnimit për të kompensuar mungesat e aftësive profesionale. Një në pesë firma kanë raportuar të kenë investuar në zhvillimin e fuqisë punëtore përmes ofrimit të trajnimit në vitin 2014. Trajnimi kryesisht fokusohet në zhvillimin e aftësive specifike të prodhimit (qoftë pa shkëputje nga puna apo përmes kurseve, punëtorive, etj.). Ofrimi i trajnimit për aftësi të përgjithshme (p.sh. prezantimit, menaxhimi i kohës, etj.) në anën tjetër, është i pashmangshëm.


Rubrika3: Rregulloret e tregut të punës

Kosova ka një treg fleksibil të punës me normë të ulët tatimore dhe kufizime të pakta në punësimin e punonjësve. Sistemi i normës së tatimit në të ardhura personale është sistemi progresiv tatimor me normë prej 0-10 %. Përveç kësaj, vetëm një kontribut pensional prej 5% nga paga e plotëpaguhet nga punëdhënësi (gjersa 5% të tjera nga paga e punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka aplikuar një pagë minimale prej €170, apo €130 për individët nën moshën 35 vjeçe. Që nga viti 2011, marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin e punës (nr. 03/L-212) i cili merr parasysh Konventatë ONP-se (ILO), legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë dhe ekonomisë së lirë. Që nga viti 2013, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë (nr. 04/L-161).

Asetet dhe investimet

Vlera e përgjithshme e asetëve të raportuara nga bizneset e anketuara ka mbetur kryesisht e njëjtë ndërmjet vitit 2013 dhe 2014. Në përgjithësi, pjesa e tokës në asetet e përgjithshme është njëtëpër firmat e madhësive të ndryshme, ndërsa pjesa e makinerisë dhe pajisjeve në asetet e përgjithshme rritet me madhësinë e firmës (Figura 10). Nga firmat të cilat kanë raportuar asetet, mikro-firmat mesatarisht kanë asete prej 56,000€, ndërsa firmat e vogla kanë asete prej 860,000€.

Figura 10: Struktura e asetëve sipas madhësisë së firmave



Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Pesëmbëdhjetë përqind e bizneseve të intervistuar kanë raportuar investim në vitin 2014. Vlera e përgjithshme e këtyre investimeve ishte rreth 1.7 milionë€ dhe ky investim ishte kryesisht i fokusuar në blerjen e makinerisë dhe pajisjeve të reja.

Rreth 10% e firmave gjithashtu kanë raportuar inovacione në sipërmarrje: kryesisht përmirësime të metodave të prodhimit apo prezantimit të produkteve të reja, pasuar nga prezantimi i dizajnit/technikës së re të paketimit.

Më pak se 3% e firmave të anketuara kanë raportuar se kanë regjistruar një patent në Kosovë. Firmat e anketuara nuk e shohin si pengesë procesin e regjistrimit të patentave për zhvillimin e biznesit. Ngjashëm, niveli i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) nuk duket të konsiderohet si faktor relevant për zhvillimin e sektorit.

Rubrika 4: Prona industriale dhe patentat në Kosovë

Markat tregtare rregullohen me Ligjin për Markat Tregtare (Nr. 02/L-54)). Markat tregtare regjistrohen në Agjencinë Kosovare për Pronësi Industriale. Pas regjistrimit, zotëruesi i markës tregtare të regjistruar ka të drejta ekskluzive në lidhje me mallrat dhe/ose shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Në veçanti, këto të drejta janë: përdorimi i markës tregtare, autorizimi i dikujt tjetër për përdorimin e markës tregtare apo marrjen e mjetit juridik për shkeljen e markës tregtare. Marka tregtare është regjistruar për një periudhë prej 10 viteve dhe mund të rinovohet për një kohë të pakufizuar.

Dizajni industrial rregullohet me Ligjin për Dizajnin Industrial (Nr. 04/L-038). Dizajni mbrohet me ligj deri në masën që është një risi dhe ka një karakter të veçantë. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet maksimalisht për 25 vite.

Patentat rregullohen me Ligjin për Patentat (Nr. 2004/49). Një shpikje do të jetë e patentueshme nëse ajo është e re, përfshin një hap inventiv dhe është e zbatueshme në industri. E drejta e patentës jepet për kohëzgjatje prej 20 viteve.


Standardizimi rregullohet me Ligjin për Standardizim (Nr. 03/L-144). Certifikimi i produkteve, përpunimit, shërbimeve, sistemeve të cilësisë dhe personelit rregullohet me Ligjin për Standardizim dhe institucioni përgjegjës për lëshimin, aplikimin dhe përcaktimin e standardeve është Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS).

Kompanitë e anketuara konsiderojnë që procedurat për patenta janë të thjeshta.

Mjedisi afarist

Bizneset e radhisin korrupsionin si barrierën kryesore, të pasuar nga niveli i taksave dhe mos-efikasiteti i administratës tatimore, konkurrenca nga sektori joformal, disponueshmëria dhe kostoja e energjisë dhe mos efikasiteti gjykatave (Figura 11). Marrja e licencave afariste, qasja në tokë, infrastruktura jo e duhur lokale dhe koston e punës, në anën tjetër, janë ndër barrierat e radhitura më së ulëti.

Figura 11: Barrierat në zhvillimin e biznesit




Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Atëherë kur të dhënat ndahen sipas madhësisë, dalin disa dallime në intensitetin e raportuar të disa barrierave për zhvillimin e biznesit (Figura 12). Në përgjithësi, firmat e vogla dhe të mesme raportojnë intensitetet më të lartë të barrierave. Firmat e vogla dhe të mesme caktojnë një intensitet më të lartë ndaj barrierave si qasja në financa, marrja e licencave biznesore, mos efikasiteti i doganave, qasja në teknologji, niveli i taksave, kostoja e lëndëve të para (përfshirë punën) dhe në masë më të vogël, cilësia e lëndëve të para (me përjashtim të punës). Kjo mund të shpjegohet, së paku pjesërisht, nga një kombinim i faktorëve kontekstual. Në krahasim me homologët e tyre në nivel mikro - të cilët kanë gjasa të jenë kryesisht biznese familjare - bizneset e vogla dhe familjare janë më ambicioze në planet e tyre të zgjerimit dhe eksportit dhe prandaj janë më të ndikuara nga qasja në financa dhe teknologji, kosto (dhe cilësi) të lëndëve të para dhe mos efikasitetit të doganave. Dallimi i sa i përket intensitetit të nivelit të taksave mund të jetë për shkak të tatimeve të ndryshme ndaj të cilave janë subjekt firmat; d.m.th. firmat relativisht më të mëdha kanë gjasa të tejkalojnë prapen e shitjes për pagesën e TVSH-së.


Mikro-firmat, në anën tjetër, caktojnë një intensitet më të lartë të korrupsionit, mos efikasitetit të gjykatave dhe disponueshmërisë dhe koston e energjisë.

Figura 12: Barrierat në zhvillimin e biznesit sipas madhësisë së firmës



Dallimet në intensitetin e barrierave në nën-sektorë janë më pak të theksuara (Figura 13). Aty ku ekzistojnë dallime, intensiteti i barrierave të raportuara ka tendenca të jetë më i lartë në prodhimin e produkteve tjera të plastikës dhe gomës. Për shembull, kjo është e njëjtë me marrjen e licencave biznesore, disponueshmërisë dhe kostone energjisë, qasjen në financa, tokë dhe teknologji/pajisje dhe cilësinë e lëndëve të para dhe produkteve të papërpunuara. Kjo mund të jetë për shkak të nivelit më të ulët të zhvillimit të firmave në këtë nën-sektor, për dallim nga nën-sektori i mjeteve të plastikës të ndërtuesve, i cili është më i zhvilluar.

Figura 13: Barrierat ndaj zhvillimit të biznesit sipas nën-sektorit



Burimi: Anketa e UNDP-së (2015)

Rubrika 5: Institucionet relevante

- ✓ Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (regjistrimi i biznesit), <http://www.arbk.org/>
- ✓ Agjencia për Promovimin e Investimeve të Kosovës (mbrojtja dhe promovimi i investimeve, mbështetja e zbatimit të politikave publike dhe programeve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, <http://www.invest-ks.org/>
- ✓ Administrata Tatimore e Kosovës (pagesa e taksave), <http://www.atk-ks.org/>
- ✓ Qendrat për Shërbimin e Qytetarëve në komuna (burimet e informacionit dhe shërbimet e këshillimit)
- ✓ Dogana e Kosovës (informacionet mbi detyrimet dhe procedurat doganore), <https://dogana.rks-gov.net>
- ✓ Shoqatat Afariste (rrjetet afariste, panaireset, misionet tregtare, avokimi, etj.): Oda Ekonomike; Oda Ekonomike Amerikane; Aleanca Kosovare e Biznesit.

Rubrika 6: Lista e lejeve dhe certifikatave relevante

- ✓ Certifikata e biznesit
- ✓ Regjistrimi me Administratën Tatimore të Kosovës
- ✓ Regjistrimi i punonjësve për skemën pensionale me Administratën Tatimore
- ✓ Vërtetimi i mbrojtjes nga zjarri
- ✓ Vërtetimi për ujë
- ✓ Leja e Ndërtimit
- ✓ Lidhja në energji elektrike

Storia e suksesit: Ferplast

Ferplast është prodhues i tubave të plastikës në Ferizaj. Produktet e saj përfshijnë gypat për ujësjellës, kanalizim dhe drenazhim, dhe për mbrojtjen e kabllove. Ferplast është themeluar në vitin 1996 nga investitorët vendor dhe aktualisht ka të punësuar 41 punonjës. Kapitali fillestar, si dhe rritja e kompanisë, janë financuar nga kapitali vetanak. Kompania nuk ka shfrytëzuar kreditë bankare dhe përgjatë 20 viteve të operimit të saj ka pranuar një grant modest nga donatorët për bashkë-financimin e kostosfillestare të futjes në përdorim të ISO standardeve në vitin 2007.

Tregu kryesor i Ferplast-it është Kosova, pasuar nga Shqipëria; destinacionet tjera të eksportit përfshijnë Maqedoninë, Bullgarinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Zvicrën. Kompania ka filluar të eksportojë nga viti 2009 dhe që nga atëherë ka arritur të rrisë vazhdimisht eksportin, duke arritur në 1.4 milionë Euro në vitin 2015 (nga vetëm 77,000 Euro në vitin 2009). Perspektivat eksportuese të kompanisë janë raportuar të jenë të ndritshme si rezultat i: (i) një investimi të ri në një linjë të re të prodhimittë gypit Ø2000 i cili nuk prodhohet në rajon, dhe (ii) lirimi i makinerisë dhe lëndëve të para nga pagesa e TVSH-së (në kufi) nga viti 2015.

Menaxhmenti i kompanisë ia atribuon suksesin e tij investimeve të vazhdueshme në teknologjinë e re. Certifikimi me ISO standard konsiderohet si thelbësor për kompanitë në sektorin që synojnë të importojnë. Kur janë pyetur se pse kompanitë Kosovare nuk i zbatojnë këto standarde, menaxhmenti i Ferplast thekson se është i shtrenjtë – e jo aq shumë kostoja fillestare e certifikimit, por kostoja e respektimit të vazhdueshëm të këtyre standardeve.

Sipas Ferplast, pengesat kryesore me të cilat përballlet sektori janë të ndryshme. Një nga këto është furnizimi dhe kostoja e energjisë, veçanërisht tarifat e larta gjatë dimrit, të cilat dyfishojnë kostot e energjisë dhe bëjnë që kompania të punojë me kapacitet të dukshëm më të ulët gjatë muajve të dimrit; si rezultat, disa nga punonjësit e saj mbeten pa punë për periudha kohore (disa muaj) dhe kompania nuk mund të akumulojë stoqe të cilat do t'ia mundësonin asaj të jetë më fleksibile në vendosjen e çmimeve të produkteve dhe kështu të jetë më konkurruese në tregjet rajonale. Konkurrenca e produkteve të importuara të lira por me cilësi të ulët (d.m.th. produktet që janë nën standardet e industrisë, p.sh. për shkak të lëndëve të para apo peshës jo të duhur), të cilat nuk testohen në kufi është një faktor tjetër kyç që pengon konkurrueshmërinë e kompanive lokale (jo vetëm në këtë sektor), sipas Ferplast. Në anën tjetër, autoritetet në vendet rajonale jo vetëm që nuk lejojnë importet e produkteve me cilësi të ulët, por gjithashtu dekurajojnë importet përmes procedurave të gjata burokratike.

Disponueshmëria dhe cilësia e punonjësve të aftësuar nuk konsiderohet e kënaqshme por kompania është përballur me këtë problem përmes përvojës dhe trajnimit të vazhdueshëm: sa herë që prezantohet një makineri e re, furnizuesi i makinerisë kontraktohet për ofrimin e trajnimit të specializuar dy mujor dhe kjo ka qenë e mjaftueshme për trajnimin e personelit të prodhimit, ndërsa personeli i laboratorit testues të kompanisë është dërguar për trajnim jashtë vendit.

Së fundi, mungesa e informacioneve mbi tregun dhe ideve inovative mbi atë se ku të investohet besohet të jenë një pengesë për këtë sektor, si dhe sektorin privat në përgjithësi. Si rezultat, në vend të investimit në produktet inovative konkurruese, firmat nganjëherë thjesht kopjojnë kandidatët dhe përfundojnë duke bërë investimeve jo të duhura në sektorë të ngopur. Publikimi i të dhënave të tregut, si p.sh. mbritrendet e importeve për produkte specifike, konsiderohet të jetë përpjekje e thjeshtë – por e rëndësishme – që mund të ndërmerret nga institucionet në këtë aspekt.



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

www.mti-ks.org